

DORACAKËT PROFESIONAL, PUNËTORI GJITHËPËRFSHIRËSE



Agjencia Kadastrale e Kosovës ka ndërmarrë iniciativa profesionale për azhurnimin e doracakëve të punës, me qëllim të reflektimit të ndryshimeve legjislative në punët e përditshme që kryhen nga gjeodetët dhe kompanitë e licencuara gjeode dhe nga Zyrtar Kadastrale Komunale. Ndërsa me qëllim të gjithëpërfshirjes në draftimin e këtyre dokumenteve Agjencia Kadastrale e Kosovës ka organizuar disa punëtori ku ekspertët do të mund të jepnin kontributin e tyre profesional me qëllim që doracakët të jenë sa më të detajuar dhe për të marrë parasysh interesat e ndryshme profesionale dhe shoqërore në gjatë kryerjes së punëve gjeodezike. Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti është rishikimi dhe azhurnimi i udhëzimeve dhe manualeve të punës ekzistuese të cilat trajtojnë proceset e Rindërtimit të Informacioneve Kadastrale, Kadastrit të Ndërtesave, aktiviteteve të matjeve gjeodezike dhe kadastrale, regjistrimit të pronave etj. Deri tani janë zhvilluar dy aktivitete të parapara me projekt, aprovimi i raportit fillestar dhe planit dinamik si dhe mbajtja e punëtorisë së parë. Bazuar në kërkesat dhe specifikat teknike si dhe raportin fillestar për këtë projekt, OE në punëtorinë e mbajtur në AKK ka prezantuar

aktivitetin e analizave dhe studimit të hollësishëm të dokumentacionit i cili ishte subjekt i kësaj kontrate, rekomandimet bazike të cilat do të shërbejnë në hartimin e draft udhëzuesve, rekomandimet të cilat derivojnë si kërkesë për përmirësimin dhe azhurnimin e udhëzuesve ekzistues si dhe rekomandimet të cilat kanë të bëjnë me udhëzuesit e ri të punës të cilat derivojnë si kërkesa nga Udhëzimet Administrative të aprovuara në Nëntor të vitit 2019. Në punëtori e parë kanë marrë pjesë 19 ekspertë nga grupet kryesore të interesit si përfaqësueses të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Zyrtar Kadastrale Komunale,

Shoqatës së Gjeodetëve si dhe gjeodetë të licencuar. Në punëtori e parë është konkluduar që të gjithë udhëzuesit e punës të jenë pjesë e një dokumenti të vetëm i cili do të jetë si bazë udhëzuese për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve që kanë të bëjnë me matje, krijim të njësive kadastrale, standardizim të të gjitha aspekteve teknike dhe procedurale për krijim dhe regjistrim të njësive kadastrale etj. Bazuar në rekomandimet e prezantuara dhe diskutimet e bëra gjatë punëtorisë, gjithashtu është konkluduar që OE të vazhdojë me hartimin e udhëzuesve të diskutuar në mënyrë të detajuar nga aspekti teknik dhe ato të dorëzohen në AKK për shqyrtim në Janar të vitit 2020, në mënyrë që komentet dhe sugjerimet e bëra nga AKK dhe grupet e interesit të inkorporohen nga OE në draft versionet finale janë prezantuar edhe në punëtorinë e dytë që ishte mbajtur në datat 29,30 dhe 31 dhjetor në Shkodër. Diskutimet, sugjerimet dhe rekomandimet e dala nga punëtorinë e dytë do të inkorporohen në versionet përfundimtare të dokumenteve-udhëzuesve në mënyrë që AKK të bëjë aprovimin e tyre dhe sa më parë të fillojë përdorimi i tyre e në veçanti aktivitetet të cilat do të trajtohen në udhëzuesit e rinj të punës që derivojnë si kërkesa nga Udhëzimet Administrative.



AKK, takim me kryetarin e Komunës së Pejës

Agjencia Kadastrale e Kosovës si rezultat i reformave të ndërmarra ligjore ka sjell në fuqi 11 udhëzime të reja administrative nga fusha e kadastrës, regjistrimit të pronës dhe sistemit të unifikuar të adresave. Ndërsa disa nga këto udhëzime administrative kanë pasur ndikim edhe në kryerjen e punëve kadastrale nga Zyrat Kadastrale Komunale. Për këtë arsye, me ftesë të Kryetarit të komunës së Pejës z. Gazmend Muhaxhiri, Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës i shoqëruar nga u.d Drejtori i Drejtorisë për Kadastër z. Korab Ahmetaj dhe Eksperti i Lartë Ligjor z. Bashkim Shaqiri




kanë qëndruar në një vizitë zyrtare në këtë Komunë. Theks kryesorë në takim kishte ndarja dhe bashkimi i parcelave në zonat urbane dhe rurale bazuar në udhëzimet e reja administrative, trajtimi i parcelave të krijuara që shfrytëzohen si rrugë, ndërimi i destinimit të tokës, emërtimet e rrugëve të reja e ngjashëm. Në takim, Kryeshefi i AKK-së informoi z. Muhaxherin po ashtu edhe ekspertët nga kjo Komunë mbi çështjet e ngritura. Po ashtu, ekspertët e AKK-së ofruan përkrahje me tërë kapacitetet profesionale në rastet kur do të ketë nevojë për një gjë të tillë. Po ashtu, si konkludim

i dyanshëm nga takimi ishte nevoja për vazhdim të bashkëpunimit përmes monitorimit të punëve të Zyrës Kadastrale Komunale dhe përmes shkëmbimit të ekspertizave profesionale e ligjore.



Policia e Kosovës ofron informacione në gjeoportali



Agjencia Kadastrale e Kosovës si organ kompetent për koordinimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacioneve Hapësinore (IKIH) dhe administratore e Gjeoportalit shtetëror, ndërmerr iniciativë të ndryshme me institucione publike për informimin mbi benefitet nga publikimi i të dhënave të interesit publik në Gjeoportalin shtetëror. Ndërsa si rezultat i bashkëpunimit mes AKK-së dhe Policisë së Kosovës më këtë fushë, në Gjeoportalin shtetëror janë

publikuar edhe disa të dhëna nga Policia e Kosovës, respektivisht Stacionet Policore (drejtori rajonale policore, stacione policore, nënstacione policore, stacione administrative policore, stacione policore të trafikut) dhe Stacionet Policore Kufitare (drejtoritë rajonale të policisë kufitare, stacione policore kufitar, pikat e kalimit kufitar, stacione për mbikëqyrje të kufirit). Të gjitha këto të dhëna tani më janë të qasshme përmes Gjeoportalit shtetërorë në linkun <http://geoportal.rks-gov.net/>.

Informata mbi AKK

Agjencia Kadastrale e Kosovës (në vijim të tekstit AKK) është autoriteti qendror për mirëmbajtjen e bazës së të dhënave kadastrale, për mirëmbajtjen e regjistrave pronësorë, për hartografi dhe GIS, për sistemin e unifikuar të adresave, për infrastrukturën kombëtare të të dhënave hapësinore (në vijim të tekstit, IKIH) dhe për administrimin e Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacioneve (TI) respektivisht qendrës së parë dhe të dytë të të dhënave.

KRYESHEF EKZEKUTIV
Avni Ahmeti
Avni.Ahmeti@rks-gov.net

DREJTORATI LIGJOR
bashkim.shaqiri@rks-gov.net

DREJTORATI I FINANCAVE
DHE ADMINISTRATËS
Fazile Hamiti
Fazile.Hamiti@rks-gov.net

DREJTORATI I TEKNOLOGJISË SË
INFORMACIONIT
Afërdita Thaçi
Afërdita.Thaci@rks-gov.net

DREJTORATI I KADASTRËS
Korab Ahmetaj
Korab.Ahmetaj@rks-gov.net

QASJA E GRUAS NË PRONË
Ibadete Rexhepi
Ibadete.Rexhepi@rks-gov.net

QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE DHE
INFORMATA TË PËRGJITHSHME
akk@rks-gov.net



AKK dhe Banka Botërore, përfshirja e qytetarëve në projekte

Agjencia Kadastrale e Kosovës si organ kompetent për kadastrë dhe pronë implementon projekte kapitale që në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me qytetarët, dhe rregullisht përmes informimit përpiqet që të inkurajojë të njëjtit për pjesëmarrje aktive në faza të ndryshme të implementimit të projekteve të saja, si përmes informimeve dhe shikimeve publike, po ashtu edhe përmes zhvillimit të kanaleve të ndryshme të

komunikimit për informim të qytetarëve. Për këtë arsye, një ekip i Agjencisë Kadastrale të Kosovës ka marrë pjesë në punëtorinë e organizuar nga Banka Botërore që kishte për qëllim shkëmbimin e përvojave mes njërive për implementim të projekteve të Bankës Botërore në katër shtete të regjionit, respektivisht Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Kosovë dhe Malit të Zi. Në takim, ekspertë të ndryshëm të Bankës Botërore nga fusha e gjithëpërfshirjes dhe

komunikimit prezantuan metodologji dhe teknika të ndryshme të përdorura nga shtetet e zhvilluara në përfshirjen e qytetarëve gjatë fazave të ndryshme të implementimit të projekteve, si dhe prezantuan edhe aplikacione të ndryshme të zhvilluara për këtë qëllim. Po ashtu, edhe pjesëmarrësit prezantuan aktivitetet e tyre në këtë fushë ndërsa ndanë edhe sfidat me të cilat ballafaqohen si dhe prezantuan mjetet për tejkalimin e atyre sfidave.

Vazhdon përkrahja Norvegjeze

Agjencia Kadastrale e Kosovës që nga themelimi i saj ka qenë e përkrahur nga Autoriteti Norvegjez për Kadastrë dhe Hartografi "Kartverket", si përmes financave po ashtu edhe përmes ekspertizës. Me përkrahjen e norvegjezëve janë zhvilluar projekte të ndryshme kapitale në fushën e sistemit të adresave dhe zhvillimit të sistemeve dhe moduleve për informacionet kadastrale për tokën në Kosovë. Ndërsa duke pas parasysh faktin se marrëveshja e fundit për bashkëpunim dhe përkrahje është kah

përfundimi si dhe duke ekzistuar vullneti i dyanshëm për vazhdim të bashkëpunimit, sot është mbajtur një takim virtual mes kreut të Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti dhe Udhëheqësit për Bashkëpunim Ndërkombëtar pranë "Kartverket" z. Kåre Kyrkjeeide, të dytë të shoqëruar edhe me bashkëpunëtorë profesional. Qëllimi i takimit ishte identifikimi i fushave të interesit për bashkëpunim në të ardhmen si dhe shkëmbimi informacioneve rreth mënyrës së aplikimit për fonde për

përkrahje. Po ashtu duke marrë parasysh se për momentin AKK është duke zhvilluar disa projekte me përkrahje financiare norvegjeze për sistemin e adresave në disa Komuna në Republikën e Kosovës, në takim u prezantua ecuria e tyre, rezultatet dhe sfidat.



AKK, takim me FSK

Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti i shoqëruar edhe nga u.d Drejtori i Drejtorisë për Kadastrë z. Korab Ahmetaj, mbajti një takim pune me përfaqësues të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes respektivisht me Drejtoreshën Ligjore pranë kësaj Ministrie z-nja Krenare Sogojeva Dermaku dhe me

Drejtorin e Logjistikës z. Mentor Zejnullahu. Pas shkëmbimit të informacioneve të përgjithshme rreth aktiviteteve të institucioneve respektive, boshti i takimit ishte rreth gjendjes aktuale të pronave në të cilat është e vendosur FSK, njoftimi për pronat e ish armatës e të cilat mund të jenë në interes të FSK-së

OBJEKTIVAT DHE PROJEKTET E PARAPARA PËR VITIN 2020



Agjencia Kadastrale e Kosovës, në përputhmëri me nevojat e institucioneve dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës, dhe në pajtueshmëri me vizionin e saj, aktivitetet e saja për vitin 2020 i ka të ndara në objektiva, ndërsa për realizimin e këtyre objektivave është paraparë edhe realizimi i projekteve kapitale si nga buxheti i Republikës së Kosovës, po ashtu edhe nga huamarrja nga Banka Botërore. Në tabelat në vijim mund të gjeni informacione mbi objektivat dhe projektet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës:

Objektivat:

1. Zhvillimi dhe harmonizimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës ligjore mbi pronën e paluajtshme
2. Zhvillimi institucional i AKK-së si bartës kryesor i zhvillimit të Kadastrit dhe Administrimit të tokave në Kosovë
3. Zhvillimi i resurseve njerëzore dhe trajnimi i stafit të AKK
4. Zhvillimi i mëtutjeshëm i Sistemit Informativ Kadastral të Tokës në Kosovë (SIKTK)
5. Regjistrimi sistematik i pronave të paluajtshme

6. Zhvillimi i infrastrukturës kombëtare të të dhënve hapësinore -IKIH (ang.NSDI)
7. Krijimi i Sistemit të Arkivimit Digjital
8. Zgjerimi i Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit
9. Projekti i regjistrimit të pronës në Kadastër dhe Infrastruktura Gjeohapësinore REGIP (Projekt i Bankës Botërore)

Projektet nga huamarrja

1. Kontrolli i Kualitetit i kontraktorëve për Rindërtim të Informacioneve Kadastrale
2. Implementimi i strategjisë dhe planit të veprimit për informim të publikut
3. Zhvillimi i softuerit për rritjen e cilësisë së të dhënave në SIKTK
4. Korrektimi i të dhënave në SIKTK
5. Zhvillimi i Gjeoportalit të ri shtetëror
6. Zhvillimi i modulit për gjeodetët dhe kompanitë e licencuara

Projektet nga buxheti i Kosovës

1. Rindertimi i Informacioneve kadastrale
2. Skanimi i dokumenteve arkivore
3. Përmirësimi i sistemit të KOPOS-it (duke përfshirë- shtimi i stacioneve, softuerët, hardueret, licencat, pajisjet etj)
4. Rindërtimi i Informacioneve kadastrale
5. Mirëmbajtja e sistemit të informacioneve kadastrale të tokës në Kosovë
6. Zgjerimi i qendrës së të dhënave (HW-SW)
7. Zgjerimi i intranetit të AKK-së me module të reja
8. Skanimi i dokumenteve arkivore
9. Matjet relative gravimetrike
10. Projekti kadastrit të patundshmërive dhe infrastrukturës gjeohapësinore
11. Harmonizimi i të dhënave kadastrale në SIKTK
12. Rrjeti i nivelimit dhe sistemit referent i lartësive
13. Kompletimi dhe finalizimi i sistemit të adresave
14. Zhvillimet e reja në SIKTK